



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300503/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Elbasan.

Drejtuar: Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Tofik SINANI
Drejtor i IEVP-së Elbasan

ELBASAN

I nderuar z. Abrija,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi në IEVP Elbasan.

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Elbasan, u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Inspektimi u krye në datë 24.05.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të tyre. U inspektuan ambientet në regjimin e brendshëm të institucionit, në lidhje me plotësimin e kushteve

materiale dhe infrastrukurore për jetesë dhe zhvillimin e aktiviteteve për të burgosurit, si dhe verifikoi zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Vizita inspektuese ishte pa lajmëruar dhe pa mbikqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave me të paraburgosurit. Grupit të monitorimit ju krijuan kushte pune nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm me drejtuesit dhe stafin e institucionit, me qëllim arritjen e objektivave të inspektimit dhe në përputhje me metodologjinë e inspektimit në burgje.

Ekspertët e MKPT-së, patën akses të plotë për të inspektuar ambientet e banimit të të paraburgosurve, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, klasat e edukimit, kuzhinën, lavanderinë etj., si dhe bënë kqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga secili prej sektorëve të institucionit. U zhvilluan gjithashtu edhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Inspektimi në IEVP Elbasan, ishte në kuadër të vizitave periodike që po zhvillon MKPT për vitin 2023, në institucionet e vuajtjes së dënimit të personit dhe institucionet e sistemit penitenciar, sipas kompetencave ligjore të parashikuara në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Bazuar në metodologjinë e inspektimit, grupi i MKPT-së u takua me ish-drejtorin e IEVP-së Elbasan z.Arben Xhina dhe shefin e policisë z.Shaban Kalemi, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Në vijim grupi i inspektimit, u informua nga drejtuesit e institucionit në lidhje me respektimin e të drejtave të të paraburgosurve në këtë institucion, kushtet e jetesës të krijuara në dhomat e banimit, gjendjen e ambienteve të përbashkëta dhe të ajrimit, funksionimi i sistemit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ ankesave, si dhe për gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, ka filluar funksionimin më 2 tetor të vitit 2012. Ai është i ndërtuar në ambientet e brendshme të ish-Kombinatit Metalurgjik dhe ofron standarde përgjithësisht të mira për sa i përket kushteve për jetesë normale të të paraburgosurve, si dhe ambienteve në dispozicion të aktivitete të përbashkëta dhe për ajrim. Ky institucion (pavarësisht përprjekjeve që po bën DPB-ja për ta venë në funksionim), sjell edhe një tjetër standard të kursimit të energjisë elektrike, nëpërmjet vendosjes të paneleve diellore në tarracat e godinave në regjimin e brendshëm.

¹ Shkresë nr.K4/I45-2 prot., datë 17.10.2022 dërguar DPB dhe IEVP Elbasan.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, IEVP Elbasan kategorizohet “institucion paraburgimi” i sigurisë së zakonshme.

Kapaciteti fizik i institucionit, me urdhër nr.735, datë 04.05.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është për trajtimin dhe **akomodimin e 160 personave**. Në ditën e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm **ndodheshin 140 të paraburgosur**.

Grupi i inspektimit, mori informacion për dinamikën e popullimit në këtë institucion dhe për periudhën e fundit 6-mujore, ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. Nëntor 2022	-	160 të paraburgosur
2. Dhjetor 2022	-	148 të paraburgosur
3. Janar 2023	-	137 të paraburgosur
4. Shkurt 2023	-	144 të paraburgosur
5. Mars 2023	-	144 të paraburgosur
6. Prill 2023	-	138 të paraburgosur

Referuar statistikave dhe informacionit të drejtuesve të institucionit, nuk u evidentua që institucioni të ketë patur situata mbipopullimi apo raste të personave që të flenë me dyshekë të vendosur në tokë.

Organika e IEVP-së Elbasan ishte e miratuar me urdhër nr.174, datë 19.10.2022 të Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të sistemit të institucioneve të saj”. Ajo përbëhet **nga 143 punonjës**, nga të cilët 33 punonjës civil dhe 110 punonjës me status policie.

Sipas informacionit, institucioni aktualisht ka mungesa në organikë:

- ❖ punonjës civil 2 vende vakante, 1 farmacist dhe 1 sekretari/protokoll;
- ❖ punonjës policie 12 vende vakante (4 PRM dhe 8 PRB).

Mungesat në organikë të stafit civil nuk ndikonin në ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin e të paraburgosurve. Ndërsa, mungesat në sektorin e policisë, kryesisht në pozicionin e specialistit të policisë të rolit të mesëm (4 oficer), ndikonin në nivelin e gadishmërisë dhe të sigurisë të këtij institucioni. Ndaj vlerësojmë se, është nevojshme plotësimi sa më parë i vendeve vakante në sektorin e policisë.

U verifikua zbatimi i rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, nga ku rezultoi se:

- ✓ Ishin lidhur kontratat e punës midis të punësuarve me IEVP, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në VKM nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e

rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”.

- ✓ Ishin krijuar ambiente të veçanta në secilin sektor që shërbenin si lavanderi dhe për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe ishin hequr kordonët dhe litarët në dhomat e banimit.
- ✓ Ishin afishuar në vende të aksesueshme për të paraburgosurit numrat e telefonit të Avokatit të Popullit, si dhe funksiononte linja e telefonit për komunikimin me institucionin tonë.
- ✓ Ishin kryer investime në ambientet e dusheve për ajrimin, eliminimin e lagështirës, lyerjen dhe dizifektimin e tyre, si dhe për përmirësimin e higjenës në këto ambiente.
- ✓ Ishte bërë funksionale kaldaja e institucionit, e cila shërbente për ngrohjen e ujit për larjen e trupit.
- ✓ Ishin marrë masa nga ana e institucionit dhe sektori i shëndetësisë, për kryerjen pa vonesa të vizitave mjekësore të pacientëve pranë mjekëve specializuar në Spitalin Rajonal Elbasan.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet nuk ishin zbatuar, si më poshtë vijon:

- ✓ Struktura organike e institucionit, kishte ende vende vakante në stafin civil dhe punonjësit me status policie.
- ✓ Ambienti i palestrës nuk ishte pajisur me vegla force, me qëllim ushtrimin fizik të të paraburgosurve.
- ✓ Institucioni nuk kishte lidhur marrëveshje me QFP dhe qëndrat social-kulturore e sportive në qytetin e Elbasanit, me qëllim shtimin e aktiviteteve të larmishme për të paraburgosurit.

Trajtimi i të paraburgosurve

Qëllimi i vizitës inspektuese në institucion, ishte identifikimi i rasteve të dhunës, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të lejuar apo presionit psikologjik ndaj tyre. Në intervistat me të paraburgosurit, grupi i monitorimit nuk mori ankesa prej tyre dhe nuk evidentoi raste të keqtrajtimeve nga punonjësve të policisë të institucionit.

Grupi i inspektimit evidentoi se kushtet infrastrukturore dhe materiale, si dhe shërbimet për të paraburgosurit, ishin përgjithsisht të plotësuara. Gjendja fizike, shëndetësore dhe ajo psiko-sociale e të paraburgosurve gjithashtu paraqitej e mirë dhe e qëndrueshme. Nga ana e tyre, nuk u paraqitën ankesa individuale për shkelje apo mohim të të drejtave ligjore nga drejtuesit dhe punonjës të veçantë të institucionit.

Pavarësisht situatës pozitive, të paraburgosurit ngritën disa shqetësime që lidhen me vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku i institucionit dhe nga mjekët specialist të Spitalit Rajonal në Elbasan. Nga ana e grupit të inspektimit u kërkua informacion dhe nga mjeku i institucionit u informuam se, vizitat mjekësore të të paraburgosurve kryhen mbi bazën e kërkesave të depozituara pranë sektorit të edukimit dhe pas miratimit nga drejtori i institucionit. Mjeku kryente vizitat mjekësore të pacientëve, në oraret e

pëcaktuara në kontratën e punës me institucionin, pasi është i punësuar me kohë të pjesshme. Ndërsa, vizitat mjekësore të pacientëve me sëmundje kronike pranë mjekëve specialist, nuk varen nga mjeku i institucionit, por kryhen në bazë të sistemit elektronik për planifikimin e vizitave. Në rastet e urgjencave, të paraburgosurit e sëmurë dërgoheshin menjëherë në urgjencën e spitalit Elbasan. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, çdo vonesë sado e justifikuar nga ana e institucionit, në kushtet e izolimit që ndodhen të paraburgosurit, përbën kufizim të të drejtës së tyre të ligjshme, për të marrë shërbim shëndetësor në kohë të shpejtë dhe cilësore, pranë spitaleve publike apo klinikave mjekësore private në qytetin e Elbasanit.

Ankesë tjetër që u ngrit nga të paraburgosurit, kishte të bënte me mungesën e aktiviteteve kulturore, edukative dhe sportive me pjesëmarrjen e gjerë të tyre. Aktivitetet e vetme që zhvilloheshin me të paraburgosurit ishte orari i ajrimit dhe lojrat e tavolinës në klasa për çdo sektor, të cilat janë të pamjaftueshme në qëllimin e tyre final, ruajtjen e shëndetit fizik e mendor, si dhe rehabilitimin e kësaj kategorie. Në këtë kuadër, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse të institucionit, kanë detyrimin që të organizojnë aktivitete të veçanta me të burgosurit, sipas nevojave dhe interesave që ata kanë. Rregullorja Europiane e Burgjeve parashikon që të burgosurve t'u organizohen veprimtari për kalimin e kohës së lirë, ku të përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera. Gjatë veprimtarive të burgosurit duhet të lejohen të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe bashkarisht të organizojnë kohën e lirë².

Një problematikë që u evidentua nga të paraburgosurit, kishte të bënte me zvarritjet e pajustificuara në arsyetimin e vendimeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nga ish-Gjykata e Apelit Durrës. Ata pretendonin se, me ndryshimin e hartës gjyqësore dhe krijimin vetëm të një Gjykate Apeli, kjo situatë do rëndohet më shumë. Grupi i inspektimit, pasi verifikoi dokumentacionin që dispononin të paraburgosurit, konstatoi se zvarritja e arsyetimit të vendimeve nga gjykatat e lartpërmendura shkonte nga 6 muaj deri në 1.5 vjet.

Kjo situatë është e patolerueshme dhe në shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale³. Por, pavarësisht se situata ka të bëjë me procedurat e organeve gjyqësore, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, administrata e IEVP-së duhet të bashkëpunojë më shumë dhe të jetë proaktive me administratat e organeve respektive, pasi është e pajustificuar një zvarritje kaq e gjatë për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Ankesa u paraqitën dhe për mungesën e larmisë së ushqimit, e cila sipas pretendimeve të tyre, ishte e njëjtë për çdo stinë. Nga inspektimi i ambientit të kuzhinës, u konstatua se menuja javore ishte e afishuar dhe e miratuar nga komisioni i institucionit. Cilësia e

² Pika 27.6 dhe 27.7 e Rregullores Europiane të Burgjeve. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

³ Neni 430/1 pika 4 e K.Pr.Penale thuhet shprehimisht se: "Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar".

gatimit të ushqimit ishte e mirë. Por, në dhomat e banimit, grupi i inspektimit gjeti pajisje për gatimin e ushqimit dhe të paraburgosur që gatuanin nga ushqimet e dërguara nga familjarët e tyre.

Një problematikë e evidentuar nga ankesat e të paraburgosurve, kishte të bënte me mungesën e klasave dhe të palestrave për ushtrime fizike. Nga inspektimi i ambienteve në dy godinat e banimit, u konstatua se, ka ambiente të lira dhe të pa shfrytëzuara, të cilat mund të kthehen në palestra apo të përdoren si klasa për të organizuar aktivitete në nivel grupi.

Masat mbrojtëse

Vëmendje e veçantë gjatë inspektimit, u kushtua verifikimit të procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve nga administrata e institucionit, funksionimi i komisionit të pritjes të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion, si dhe funksionimi i komisionit për dhënien e masave disiplinore dhe trajtimi i të burgosurve me masë disiplinore.

E drejta e të burgosurve për të paraqitur kërkesë/ankesë është e parashikuar në nenin 58 të ligjit 81/2020. Nga kontrolli i dokumentacionit dhe nga intervistat me të burgosurit, u evidentua se, sistemi i kërkesë/ankesave të institucionit funksiononte sipas kërkesave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁴. Sipas praktikës të ndjekur, specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore ishin personat përgjegjës të autorizuar të cilët çdo ditë merrnin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve. Pasi regjistroheshin në regjistrin përkatës që mbahej në sektorin e protokoll-arshivës, kërkesë/ankesat i dërgoheshin drejtorit të institucionit. Punonjësit specialistë të sektorëve, sipas shënimeve të drejtuesit të institucionit, merreshin me trajtimin dhe kthimin e përgjigjes ankuesit, brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e institucionit⁵.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për periudhën janar-maj 2023 ishin regjistruar 257 kërkesa nga të paraburgosurit, me objekt blerje TV, biseda në “skype” me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, vizitë pranë mjekut specialist në Spitalin Rajonal Elbasan, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj. Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit. Por ata ngrinin si pretendim, mungesën e kontaktit me juristin e institucionit, në lidhje me dhënien e asistencës ligjore për çështje që shqetësojnë të paraburgosurit.

⁴ Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020: “Personeli i autorizuar **organizon takime periodike me të burgosurit, me qëllim krijimin e mundësive të paraqitjes së kërkesave ose ankesave. Rregullat dhe procedurat për shpeshhtësinë, kohën e takimeve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**”.

⁵Neni 58 i ligjit Nr.81/2020: “Çdo institucion **mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose të ankesave të të burgosurve në formë shkresore dhe elektronike**”.

Grupi inspektimit verifikoi gjithashtu procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të pritjes, intervistimin e të paraburgosurve, evidentimin e gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjes personale për secilin të paraburgosur, etj⁶. Në ditën e inspektimit nuk kishte hyrje të reja, por nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuara në vizitën e pranimit, regjistroheshin në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Për raste, kur të dhënat dhe fakte krijonin bindjen e arsyeshme se ndaj tij mund të jetë kryer vepër penale, personeli i IEVP-së njoftonte menjëherë organet e procedimit penal në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale. Dokumentacioni që administrohej nga komisioni i pritjes, ishte i sekretuar dhe i protokolluar në sekretarinë e institucionit.

Komisioni disiplinor ishte i ngritur dhe funksiononte me urdhër të drejtorit të institucionit⁷, i cili mbledhej jo më vonë se 48 orë nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore nga i paraburgosuri. Sipas dokumentacionit, mjeku i institucionit përgatiste një raport mjekësor paraprak, ku shprehej për gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit ndaj të cilit kishte filluar procedura disiplinore. Raporti vihej në dispozicion të komisionit disiplinor dhe shqyrtohej prej tij për efekt të përcaktimit të masës disiplinore. Mjeku i institucionit jepte sqarime për gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit nëse i kërkohej nga komisioni disiplinor, por merrte pjesë dhe ishte pa të drejtë vote në mbledhjet e komisionit disiplinor.

Në momentin e inspektimit në dhomat e veçimit ndodhej vetëm një i paraburgosur me masë disiplinore “përrjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri 14 ditë”, për shkelje të rëndë të disiplinës. E drejta e ankimit të masës disiplinore është e garantuar në ligj dhe i paraburgosuri që ndodhej në izolim, ishte i informuar por nuk e kishte ankimuar shfuqizimin e masës disiplinore⁸. Dhomat e veçimit ndodhen në godinën “B” dhe kushtet ishin përgjithësisht të mira, të kompletuara me materiale fjetje dhe kontaktet e stafit të institucionit me personat me masë disiplinore, ishin të përditëshme.

Spektori i observimit dhe tranzitit ndodhet në katin e parë të godinës “A” dhe ka 4 dhoma. Këto dhoma ishin të pajisura me krevat, dyshekë, materiale për fjetje dhe me orënditë e nevojshme si tavolinë e karrige. Në momentin e inspektimit në dhomat e observimit ndodheshin dy persona, si hyrje të reja në institucion. Nga intervistimi, të paraburgosurit

⁶ Neni 38 i ligjit 81/2020: “Komisioni i pritjes informon të burgosurin në një gjuhë të kuptueshme për të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim e ndihmë juridike të garantuar nga shteti, për rregullat e procedurat e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave, rregulloren e institucionit. I burgosuri ka të drejtë të disponojë informacionin me shkrim”.

⁷ Neni 66 i ligjit 81/2020: “Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar më parë të burgosurin ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor.

⁸ Neni 67 i ligjit 81/2020: “I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë masën disiplinore pranë komisionit të apelimit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës disiplinore”.

nuk paraqitën ankesa për trajtimin e tyre nga stafi i institucionit, por me përfundimin e procedurave të komisionit të pritjes, kërkonin sa më parë të kalonin në sektorët përkatës.

Ambientet e observimit, tranzitit dhe të veçimit ishin përgjithsisht të pastra nga ana higjeno-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje dhe për dizinfektim.

Të paraburgosurve ju lejohej të kryenin 8 (tetë) telefonata në muaj me familjarët, sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁹. Aparatet e telefonave ishin të vendosur në korridoret e secilit sektorë e vendet e ajrimit dhe ishin në gjendje pune. Të paraburgosurit nuk paraqitën ankesa për respektimin e numrit të telefonatave nga punonjësit e institucionit, por në 8 raste të paraburgosurit ngritën si shqetësim vonesat e përgjigjeve nga organi i prokurorisë, për miratimin e telefonatave me familjarët e tyre. Grupi i inspektimit e adresoj shqetësimin pranë drejtuesit dhe stafit të institucionit, të cilët e pranonin këtë shqetësim të të paraburgosurve, por sipas informacionit arsyea e vonesës ishte se, këta persona ishin nën hetim nga disa organe prokurorie, pra jo vetëm nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj dhe dinamika e miratimit të kërkesave të institucionit për telefonatat e të paraburgosurve, për shkak të ngarkesës të punës, ishte e ndryshme nga ana e tyre.

Grupi i inspektimit, verifikoi komunikimin me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit, në numrat e kontaktit që ishin të afishuara në hollin e secilit sektorë. Nga verifikimi rezultoi se, të paraburgosurit mund të komunikonin në çdo kohë dhe pa pagesë, sikurse parashikohet në ligjin 81/2020 dhe Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve.

Ambientet e takimeve me familjarët ishin në kushte të mira dhe funksionale. Ky ambient ndodhej në katin e parë të godinës A dhe kishte 7 poste për takime fizike, 2 dhoma për komunikim me “skype”, 1 dhomë për takim me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, si dhe 2 dhoma për takim të të paraburgosurve familjarë me familjet e tyre. Të paraburgosurit zhvillonin normalisht 4(katër) takime me familjarët, nga të cilët 1 takim online (ose dhe më shumë në varësi të kërkesës të të paraburgosurit), brenda numrit të lejuar për takime dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Vendet e takimeve me familjarët, janë të ndara në mes me xham dhe komunikimi i të paraburgosurit me familjarët bëhet me telefon. Të paraburgosurit ngrinin si shqetësim, mungesën e kontakteve fizike me familjarët e tyre, ndaj ata kërkonin të hiqej xhami dhe të kishin mundësi kontakti fizik me familjarët.

Dhoma e prindërimit ishte e kompletuar me orenditë e nevojshme dhe me materiale informuese, në funksion të qëllimit që ka si ambient, rritjen e ndërveprimit midis të burgosurit dhe fëmijëve të tij. Në këtë ambient, kryheshin takime të të paraburgosurve familjarë me fëmijët e tyre, por dhe me prindërit e të paraburgosurit në rastin kur ata janë me moshë të madhe. Gjithashtu, dhoma e takimeve të të paraburgosurit me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, ishte e pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige, me këmbë të fiksuara në dysHEME, për qëndrimin ulur dhe zhvillimin e

⁹ Neni 74 i ligjit 81/2020: “Të burgosurit i lejohen 8 (tetë) herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, me shpenzimet e tij”.

seancave të marrjes në pyetje të të paraburgosurve, sipas procedurave të parashikuara në K.Pr.P.

Kushtet higjieno-sanitare të dhomave që ndodhen në ambientin e takimeve ishin përgjithësisht të mira, por edhe këto ambiente kishin nevojë për lyerje dhe dizinfektim të vazhdueshëm.

Grup i inspektimit zhvilloi intervista më vehte me të paraburgosurit e punësuar në këtë institucion, të cilët deklarorin se kishin lidhur kontratat e punës me institucionin, sipas nevojës së institucionit dhe kërkesave të të paraburgosurve. Por, një pjesë e tyre ngritën si shqetësim se nuk ishin kryer pagesat mujore për punën e kryer nga ana e institucionit. Nga verifikimi në vend i kësaj problematike, rezultoi se, disa të punësuar nuk ishin të pajisur me karta identiteti (nuk kanë qenë të pajisur me karta ID, kishte përfunduar afati i përdorimit apo deklarojnë se kanë humbur atë), gjë e cila nuk i mundëson të punësuarit të hapin numrat e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë. Drejtuesit e institucionit, kishin angazhimin për ti ndihmuar këta persona për ti pajisur me karta ID, pasi fondi për të kryer pagesat në bazë të numrit të miratuar të të punësuarve është në dispozicion të institucionit, sipas parashikimeve në VKM-së nr.602 datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*.

Ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, monitorohen nga sistemi i kamerave, i cili ishte në funksion të plotë. Institucioni ka të instaluar 115 kamera. Kamerat mbanin nën vëzhgim të gjitha ambientet ku kryenin aktivitetin ditor të paraburgosurit gjatë 24 orëve dhe të dhënat e tyre ruhen në një server qëndror për një periudhë 30 ditore.

Mbikqyrja me kamera e ambienteve në regjimin e brendshëm të IEVP-ve, përveç mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria, për arsye se, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve; dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës. Gjtiashu, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Kushtet materiale

Gjatë vizitës inspektuese në IEVP Elbasan, ju kushtua vëmendje e veçantë kqyrjes së kushteve infrastrukturore dhe materiale të të paraburgosurve, të cilat garantojnë të drejtat e tyre, që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave për jetesë normale dhe zhvillimin e

aktiviteteve, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e të paraburgosurve, në përfundim të vuajtjes së dënimit.

Në regjimin e brendshëm të institucionit, ndodhen 2(dy) godina për banim, godina “A” dhe godina “B”, që lidhen ndërmjet tyre me korridore të brendshme. Secila godinë ka nga katër sektorë, dy sektorë për secilin kat. Në katin e parë ndodhen ambientet ndihmëse si dhomat e takimit me familjarët, kuzhina, dhomat e observimit, dhomat e tranzitit, dhomat për takime me prokurorët dhe avokatët mbrojtës, klasat e edukimit, si dhe ambientet për kryerjen e riteve fetare.

Në katin e parë të godinave, ndodhen disa ambiente (dhoma) të ndërtuara sipas projektit, por që janë të mbyllura dhe jashtë funksionit. Në kushtet, kur të paraburgosurit ankohen për mungesën e larmishmërisë të aktiviteteve, është e domosdoshme që këto ambiente të kthehen në destinacionin për të cilin ato janë ndërtuar, por sipas drejtuesve të institucionit, kjo do të kërkonte punonjës shtesë në organikën e institucionit. Kjo problematikë, sipas drejtorit të institucionit, është ngritur në takimet e organizuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj, është duke kryer një vlerësim të përgjithshëm të ambienteve të lira që ndodhen edhe në IEVP-të e tjera, me qëllim për ti kthyer ato në ambiente funksionale.

Dhomat e banimit ndodhen në katin e 2-të dhe të 3-të të godinave. Ato janë me kapacitet për 2, 4 dhe për 6 persona (një dhomë për çdo sektorë). Sipërfaqe dhe kubatura e dhomave të banimit janë të bollshme, duke ruajtur normat e lejuara, *“kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur”*¹⁰. Dritaret e dhomave të banimit, janë me përmasa të tilla, që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar, si dhe kanë ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Ato ishin të kompletuara me materiale për fjetje si dyshekë, batanije, jastëk dhe çarçafë dhe ishin në gjendje të mirë përdorimi. Gjithashtu, ato ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolina, stola dhe raftet për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimit të të paraburgosurve. Dhomat e banimit janë me tualete dhe të pajisura me nyje hidrosanitare dhe rubineta për ujë. Ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Godinat e banimit, komunikojnë me derë më vete me bokset e ajrimit dhe fushat e sportit. Çdo godinë ka nga 2 bokse ajrimi dhe fusha sporti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive të programuara.

Çdo sektor ka në përbërje 10 (dhjetë) dhoma banimi, klasë edukimi që shërben punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore për trajtime individuale dhe në grup të të paraburgosurve, dhomë për lavanderi dhe tharje të rrobave, si dhe një ambient i përbashkët i dusheve për larjen e trupit.

Të paraburgosurve u jepej normativa me detergjentë, kova, fshesa dhe letra higjenike, çdo muaj nga sektori i logjistikës. Ata pretendonin se këto normativa janë të pamjaftueshme dhe nuk plotësojnë nevojat e të paraburgosurve për higjenë personale, larjen e teshave dhe

¹⁰ Neni 33, pika 4 e ligjit nr.81/2020.

pastërtinë e ambientit të dhomave. Në këto kushte, të paraburgosurit detyrohen të sigurojnë detergjentë shtesë nga familjarët, duke rritur koston ekonomike të familjeve të tyre.

Furnizimi me ujë kryhet nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Elbasan, sipas grafikut të miratuar në marrëveshjen e përbashkët me IEVP Elbasan. Furnizimit me ujë i ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej sipas një grafiku 4x2 orë në ditë. Pavarësisht shtimit të orarit të furnizimit me ujë, të paraburgosurit kërkonin ujë pa ndërprerje, sidomos gjatë stinës së verës, pasi koha e furnizimit me ujë ishte e pamjaftueshme për larjen e trupit dhe pastërtinë e ambienteve të banimit.

Ambienti i dusheve ishte i përbashkët për çdo sektor. Në secilin ambient, ndodhen nga dy poste dushi dhe një bolier për ngrohjen e ujit. Larja e trupit kryhej rregullisht 2 herë në javë, sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. Nisur nga nevojat në rritje të të paraburgosurve për larjen e trupit dhe nga koha e kufizuar e furnizimit me ujë të rrjedhshëm, dushet nuk i përballonin kërkesat e të paraburgosurve. Në këto kushte, disa të paraburgosur laheshin në dhomat e banimit dhe ngrohja e ujit sanitar kryhej me pajisje elektrike. Ambientet e dusheve ishin të ajrosura, të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Sikurse e theksuam më lart, infrastruktura në këtë institucion sjell një tjetër standard të kursimit të energjisë elektrike, nëpërmjet vendosjes të paneleve diellore në tarracat e godinave. Ndonëse ky investim është i realizuar, ai ende nuk është venë në funksion. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ky investim kërkon fonde shtesë në buxhetin e institucionit për ti vënë në punë, pasi do të kursente energjinë elektrike dhe njëkohësisht do të plotësonte nevojat e të paraburgosurve për larjen e trupit me ujë të ngrohtë, sa herë që kanë të nevojshme.

Orari i ajrimit i të paraburgosurve zbatohet sipas orarit të veprimeve, 2 orë çdo ditë, i ndarë në kohë sipas sektorëve dhe midis godinave. Ajrimi kryhej në bokse të ndërtuara më vehte për çdo godinë, bashkë me fushat e sportit për kalçeto. Në vlerësimin tonë, ambientet për ajrim dhe për aktivitete sportive janë me hapësira të bollshme, me streha për tu mbrojtur nga dielli dhe shiu, me aparate telefoni të instaluar në secilin boks ajrimi me qëllim që të paraburgosurit të komunikojnë me familjarët e tyre, si dhe janë të kompletuara me kushte për lojra tavoline.

Në IEVP Elbasan funksiononte rregullisht njësi tregtare online, për blerjen e produkteve të nevojshme për të paraburgosurit. Nga ana e subjektit privat që ofron këtë shërbim ishin të punësuar dy të paraburgosur, të cilët pasi merrnin çdo ditë kërkesat sipas nevojave të të paraburgosurve, kryenin porositë nëpërmjet pajisjes “iPaid” në dispozicion të tyre. Brenda 2-3 ditëve, porositë dërgohen nga subjekti privat nominalisht sipas kërkesave të të paraburgosurve. Në intervistat me të paraburgosurit, u ngrit me shqetësim ankesa për çmimet e larta të produkteve që blejnë online, si dhe pakot me ushqime në disa raste, nuk vijnë sipas porosive të të paraburgosurve. Kjo problematikë është ngritur edhe nga të burgosurit në IEVP-të e tjera, ndaj është e domosdoshme që struktura përgjegjëse në DPB

të monitorojë në dinamikë zbatimin e kushteve të kontratës me subjektin e privat që ofron këtë lloj shërbimi.

Kuzhina e institucionit, ishte në kushte shumë të mira dhe e plotësuar me pajisjet e gatimit të standardeve bashkëkohore industriale dhe me sistem ventilimi të ajrit. Gjithashtu, enët për gatim dhe për shpërndarjen e ushqimit për të paraburgosurit ishin në gjendje shumë të mirë. Ambienti i kuzhinës ishte me hapësirë, kishte dritë dhe ajrim natyral, si dhe ishte i lyer e i pastër nga ana higjeno-sanitare. Personeli i kuzhinës ishte i plotësuar sipas organikës së institucionit me 4 (katër) kuzhinierë dhe 3 (tre) ndihmës kuzhinier nga lista e të punësuarve të paraburgosur. Në ambientin e kuzhinës ishin të afishuara norma ditore e ushqimit, menuja për secilin vakt ushqimor dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe menusë së gatimit, ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe me etiketa, sipas vakteve ushqimore.

Përgatitja e ushqimit dhe shpërndarja sipas sektorëve të të paraburgosurve, kryhej me vaska me kapak dhe enë kuzhine të nikeluara e të pastra. Shpërndarja e ushqimit në secilën godinë banimi kryhej me karroca (të cilat ishin në gjendje të rregullt) dhe me krahë nga njëri sektor në tjetrin, nga shpërndarësit e ushqimit të punësuar. Kjo për faktin se, ashensorët në të dy godinat e banimit nuk ishin në gjendje pune, ndaj kërkohesh sigurimi i fondeve për vënien në funksionim të ashensorëve në të dy godinat e banimit. Pavarësisht disa pretendimeve të ngritura nga të paraburgosurit, grupi i inspektimit konstatoi se, ushqimi ishte i gatuar sipas vakteve në bazë të menusë ditore dhe ishte i një cilësie të mirë.

Regjimi dhe aktivitetet

Orari i veprimeve ishte i miratuar nga drejtori i institucionit dhe ishte i afishuar në vende të aksesueshme nga të paraburgosurit, si në klasat e edukimit dhe në korridoret që të nxirrnin për në ambientet e ajrimit. Orari përfshinte gjithë aktivitetin ditor, si dhe veprimtaritë me karakter social-kulturor dhe sportiv, që zhvilloheshin sipas programit me të paraburgosurit.

Sipas planit mujor të miratuar, punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore zhvillonin edhe seanca në kuadër të programit individual të trajtimit me të paraburgosurit, por dhe me grupe të vogla sipas sektorëve. Klasat e edukimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme, si dhe kishin ajrim e dritë natyrale. Ato ishin të kompletuara me rafte dhe libra artistik për lexim, të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, me qëllim zhvillimin e programeve psiko-sociale me të paraburgosurit. Ambienti i klasave, përdorej njëkohësisht dhe si ambient çlodhës për të paraburgosurit, pas përfundimit të kohës së ajrimit.

Nga intervistat, u evidentua se të paraburgosurit zhvillonin aktivitete të reduktuara në ambientet e ajrimit, si lojra në kalçeto dhe lojra tavoline. Në secilin sektor kishte ambiente të lira, që mund të shërbenin si ambiente për palestra, por ato nuk ishin funksionale dhe kishin mungesa në kompletimin me vegla force.

Nga inspektimi u evidentua se, nuk kishte klasa për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar, si dhe kurse profesionale për të paraburgosurit. Nga informacioni i stafit të institucionit, u evidentua se për shkak të dinamikës së lëvizjeve, të paraburgosurit nuk kishin interes për ndjekjen e shkollës apo të kurseve profesionale. Bazuar në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve” neni 45, Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve neni 61, si dhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe MAS¹¹, parashikohet se të burgosurit që nuk ka përfunduar arsimin 9-vjeçar i krijohen kushte për përfundimin e tij me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duhet të nxisin përfitimin, njohjen dhe certifikimin e arsimit, si dhe kryerjen dhe lehtësimin e ndjekjes së kurseve profesionale duke përdorur kurset me kohë të pjesshme.

Pavarësisht ambienteve dhe programeve mujore të aktiviteteve, të paraburgosurit ngritën me shqetësim mungesën e larmisë së aktiviteteve social-kulturore dhe sportive, me pjesmarrjen e gjerë të të paraburgosurve, aktivitete të cilat do të ndikonin në rritjen e aftësive ndërvepruese midis të paraburgosurve, si dhe në zhvillimin e aftësive fizike dhe psikike të tyre.

Avokatit të Popullit në vijëmesi ka shprehur shqetësimin për mungesën e aktiviteteve të larmishme me të burgosurit, pasi një orar i balancuar midis punës, edukimit dhe sportit, është me rëndësi kryesore për mirëqenien e të burgosurve që vuajnë dënimin në institucionet e sistemit të burgjeve.

Lidhur me këtë çështje Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimin Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT) pranë Këshillit të Europës, në një nga raportet e tij, thekson se, të burgosurit nuk mund të lihen të vuajnë për javë, e ndoshta muaj, të mbyllur në qeli, pavarësisht se sa të mira mund të jenë kushtet materiale në qeli. Ndaj, *“KPT konsideron se duhet synuar të sigurohet që të gjithë të ndaluarit në institucionet përkatëse të mund të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (8 orë ose më tepër) jashtë qelive, të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme”*¹².

Ndërsa Rregullorja Evropiane e Burgjeve e përforcon qëndrimin e KPT-së, duke përcaktuar në pikat 25.1 dhe 25.2 të saj se: *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹³.

Grupi i inspektimit, verifikoi plotësimin e dosjeve psiko-sociale të të paraburgosurve, lidhur me të dhënat paraprake të personalitetit të secilit prej tyre, historikun e tij, gjendjen

¹¹ Urdhër i përbashkët nr.3348/1 datë 18.04.2018 për “Rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.

¹² <https://rm.coe.int/16806ce94e>

¹³Rregullorja e Evropiane e Burgjeve

<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

e marrëdhënieve me të burgosurit e tjerë dhe stafin e institucionit, llojin e aktiviteteve që motivojnë, probleme të shfaqura me qëndrimin, sjelljen dhe përshtatjen në institucion, etj. Nga studimi i dosjeve psiko-sociale rezultoi se, ato ishin të plotësuara sipas rubrikave që përmban dosja. Punonjësit e sektorit të edukimit, kishin hartuar programe individuale trajtimi, kishin pasqyruar aktivitete të përbashkëta me diskutime në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit ose në klasat e edukimit, si dhe organizime të aktiviteteve sportive.

Stafi i sektorit të çështjeve shoqërore, sipas strukturës së re organike përbëhej nga 4 punonjës, nga të cilët 1 shef sektori dhe 3 specialistë me profesion psikolog e punonjës social dhe nuk kishte mungesa në staf.

Shërbimi Shëndetësor

Shërbimi shëndetësor për të paraburgosurit në këtë IEVP, ofrohej sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe ato ndërkombëtare, pasi të burgosurit gëzojnë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion edhe të komunitetit.

Struktura organike e personelit shëndetësor të institucionit, përbëhej nga 8 punonjës, nga të cilët 1(një) mjek i përgjithshëm, 1(një) stomatolog, 1(një) farmacist dhe 5 (pesë) infermierë. Mjeku ishte i punësuar me kohë të pjesshme 4 orë në ditë në institucion, por sipas kontratës të punës, mjeku paraqitej menjëherë në institucion në rastet e urgjencës apo në rastet e kërkesave dhe nevojave që mund kishin të paraburgosurit e institucionit. Ndërsa pozicioni i farmacistit ishte vakant dhe nuk ishte i plotësuar.

Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT-ja), gjatë vizitës që ka zhvilluar në vitin 2018 në Shqipëri, ka rekomanduar plotësimin e organikës të sektorit shëndetësor me mjek specialistë, si dhe pajisjen e kabinetit stomatologjik me një poltron dentar në IEVP Elbasan¹⁴. Nga inspektimi, u konstatua se kabinetit stomatologjik ishte i kompletuar me një poltron dentar, ndërsa mjeku ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme.

Ambienti i spitalit ndodhet në godinën kryesore të regjimit të brendshëm, i veçuar nga ambientet e banimit. Ambienti ka në përbërje dhomën e vizitave të mjekut, dhomën e infermierisë, dhoma e stomatologut, farmacia, si dhe një dhomë me 3(tre) shtretër për rastet e urgjencave për shtrimin e pacientëve të sëmurë, me rekomandimin e mjekut të institucionit. Dhomat e vizitave dhe të shtrimit, janë me hapësirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, të ajrosura dhe me ndriçim natyral dhe artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Dhoma e mjekut ishte e plotësuar me një krevat, tavolinë, karrige dhe dollap për mbajtjen e mjeteve të punës të mjekut. Kabineti stomatologjik gjithashtu, ishte i plotësuar me kabinetin e punës, duke përfshirë edhe poltronin e ri. Ndërsa infermiera, ishte e pajisur me raftet për mbajtjen e medikamenteve për të sëmurët kronikë dhe për rastet e urgjencave.

¹⁴ CPT report on Albania 2019 faqja 17

https://www.ecoi.net/en/file/local/1336989/1226_1457424142_2016-07-inf-eng.pdf

Në mungesë të farmacistit detyrën e kryente një nga infermierët, i cili ishte përgjegjës për shpërndarjen e ilaçeve të sëmurëve, sipas rekomandimeve të mjekut të institucionit. Ambientet e spitalit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa nga të paraburgosurit për mungesa në medikamente. Farmacia e institucionit ishte i furnizuar me medikamente nga DPB-ja. Për të sëmurët kronikë, farmacia furnizohej rregullisht me ilaçe sipas skemës trepalëshe mes institucionit, depos farmaceutike dhe Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (DRFSKDSH). Ndërsa për të sëmurët akutë, ilaçet siguroheshin nga vetë institucioni, përmes blerjeve të drejtëpërdrejta me fondet e destinuara në buxhetin e institucionit.

Vizitat mjeksore nga mjeku i institucionit, kryheshin sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, me kërkesë të të paraburgosurve dhe miratim të drejtorit të institucionit. Në rastin e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal Elbasan, pas lëshimit të rekomandimit nga mjeku i institucionit dhe miratimit nga drejtori i institucionit, bëhet planifikimi dhe pacientët shoqërohen nga forcat e sigurisë për kryerjen e vizitave mjeksore. Nga intervistat me të paraburgosurit, u paraqitën disa ankesa në lidhje me vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore në Spitalin Rajonal të Elbasanit apo në Spitalin e Burgjeve në Tiranë.

Drejtuesit e institucionit dhe personeli shëndetësor, shpjegonin se vonesat në kryerjen e vizitave jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrja spitalore, kryhen bazuar në procedurën e sigurisë gjatë shoqërimeve, duke ruajtur konfidencialitetin e plotë të lëvizjeve dhe shmangur çdo lloj komunikimi dhe kontakti të të paraburgosurit me jashtë. Por, në çdo rast vizitat pranë qendrave spitalore komunitare kryheshin menjëherë pas konfirmimit për orën dhe datën e zhvillimit të vizitës nga mjeku specialist.

Pavarësisht kohës dhe procedurave që duhet të ndiqen nga personeli i institucionit, Avokati i Popullit sjell në vëmendje të institucionit se, vonesat në ofrimin e shërbimit shëndetësor të nevojshëm për të paraburgosurit, përbëjnë shkelje të të drejtës për akses te mjeku specialist i këtyre personave. Vlerësimi i Avokatit të Popullit, është i njëjtë me rekomandimet e KPT-së (CPT) për këtë çështje, ku thuhet shprehimisht se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Kujdesit shëndetësor ndaj të burgosurve në IEVP, si dhe institucionet përgjegjëse për garantimin e shëndetit për të burgosurit jashtë sistemit të burgjeve, është kushtuar rëndësi e veçantë edhe në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore,*

*kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet*¹⁵.

Institucioni ishte i pajisur me ambulancë të re, me qëllim shoqërimin e të sëmurëve në rastet e urgjencave për në Spitalin Rajonal të Elbasanit, sipas kushteve për sigurinë e shëndetit dhe atë fizike të këtyre personave.

Nga këqyrja e dokumentacionit të personelit shëndetësor, u konstatua se në dhomën e mjekut ndodhej regjistri i vizitave mjeksësore, regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës dhe kartelat klinike të të paraburgosurve dhe administroheshin prej tij. Në dhomën e infermierëve ndodhej regjistri i shërbimit 24 orë, me informacione për gjëndjen shëndetësore të të paraburgosurve, si dhe regjistri i shpërndarjes së medikamenteve për të sëmurët kronikë, të cilët administroheshin nga personeli infermierëve sipas turneve. Regjistrat dhe formatet e kontrollit mjekësor ishin sipas kërkesave të protokolleve shëndetësore për llojet e sëmundjeve, të plotësuar sipas rubrikave dhe të sekretuar.

U evidentua gjithashtu se, të paraburgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore. Për shkak të dinamikës së lëvizjeve të shpeshta të të paraburgosurve, kishte disa raste të mungesave të librezave shëndetësore, por ishin duke u plotësuar nga personeli mjekësor i institucionit.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, neni 63 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; germa “b”, neni 21 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, pika 1 dhe 2/b, neni 81 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku thuhet se: *“1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.*

2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”;

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e menjëhershme, për miratimin nga DPB të Rregullores së Brendshme të IEVP-së Elbasan, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁵ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

2. Të merren masat e nevojshme nga sektori shëndetësor i institucionit, për eliminimin e vonësive të pajustificuara në kryerjen e vizitave mjekësore të pacientëve kronikë apo me probleme shëndetësore, pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal Elbasan.
3. Të merren masat e nevojshme nga sektori i çështjeve shoqërore të institucionit, për shtimin e aktiviteteve të larmishme sociale, kulturore dhe sportive, në bashkëpunim me qendrat social-kulturore e sportive në qytetin e Elbasanit.
4. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e ambienteve të reja dhe pajisjen me vegla force të palestrave, me qëllim kalimin e kohës dhe ushtrimin fizik të të paraburgosurve.
5. Të merren masa të menjëhershme, për të ofruar larmishmëri ushqimesh të shëndetëshme për të paraburgosurit sipas vakteve të ushqimeve, i pasur me vlera ushqyese dhe të ndryshohet të paktën një herë në dy javë në përshtatje me stinët.
6. Të merren masat e nevojshme, për shfrytëzimin e ambienteve që janë të mbyllura dhe vënien në funksionim, për ti kthyer ato në klasa dhe ambiente ku të paraburgosurit mund të qëndrojnë gjatë kohës së lirë apo për zhvillimin e kurseve profesionale.
7. Të merren masat e nevojshme, për planifikimin e fondeve buxhetore me qëllim vënien në funksion të sistemit të ngrohjes së ambienteve në regjimin e brendshëm me panelet diellore.
8. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucionit në pozicionin e mjekut të përgjithshëm me kohë të plotë, farmacistit dhe punonjësve të policisë së burgjeve.
9. Të merren masat e nevojshme, për organizimin e veprimtarive ditore me të paraburgosurit, me qëllim që ata të kalojnë sa më shumë kohë jashtë qelive, në përshtatje me kushtet e sigurisë dhe kushtet klimaterike.
10. Të merren masat e nevojshme, për shtimin e orarit të furnizimit me ujë në ambientet e regjimit të brendshëm, kryesisht në periudhën e verës.
11. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e kushteve të të paraburgosurve të punësuar, me qëllim pajisjen me karta identiteti dhe hapjen e numrave të llogarisë në bankat e nivelit të dytë, për efekt të pagesave mujore.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI